

SPECIAL

PRODUKTET PËR QËLLIME SPECIALE

KATALOGU



**FUQIA ËSHTË
NË DUART
TONA**

SPECIAL

PRODUKTET PËR QËLLIME SPECIALE

BK-Stone Llak për guri

Përdorimi: është llak për guri në bazë të rrëshirave akrilike, aditivëve dhe tretësve. Përdoret për të gjitha llojet e gurit natyror dhe artificial, mermerit, granitit, pllaka guri, mozaik, qeramikës, tullës. Depërton thellë në strukturën e gurit, mbron dhe konservon. Është rezistent ndaj kushteve të këqija të motit. Në një shtresë jep pamje të lagur me ngjyrë më intensive, ndërsa në disa shtresa vjen deri te rritja e shkëlqimit. Masa duhet të përzihet mirë para përdorimit. Aplikohet në 1-2 shtresa me furçë ose pistoletë. Shtresa vijuese aplikohet pas dy orësh. Për informacion të hollësishëm lexoni fletën teknike të produktit.

Shpenzimi: 0,075-0,100 l/m² për një shtresë.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 48 muaj në paketimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 750 ml



Për sipërfaqe të gurit



Thahet për 72h në 20°C



Shpenzimi 750ml 8-10 m²

BK-AquaPhobe Ngopje pa ngjyrë hidrofob

Përdorimi: është ngopje pa ngjyrë hidrofob në bazë të silanit dhe siloksanit, dedikuar për përdorim të jashtëm e të brendshëm. Është e përshtatshme për përdorim si shtresë përfundimtare ose si shtojcë për përzierjet e çimentos me qëllim të përmirësimit të hidrofobitetit të materialit. Rekomandohet për ngopjen e llaçit mineral dhe sintetik të fasadave, tullave, tjegullave, gurëve natyrorë, sipërfaqeve të betonit, fugave etj. Produkti është i dedikuar për mbrojtjen e sipërfaqeve minerale nga thithja e tepruar e ujit dhe e kimikateve agresive nga ajri që mund ta dëmtojnë dhe shkatërrojnë dukjen e ndërtesave dhe përmendoreve. E zvogëlon dukurinë e paraqitjes së kripërave nëpër sipërfaqet minerale, e zvogëlon mundësinë e zhvillimit të mikroorganizmave dhe myshkut nëpër pjesët nën hije të fasadave.

Përgatitja dhe vendosja: Para përdorimit, materiali duhet të përzihet mirë në paketim, ndërsa pastaj produktin e patretur duhet të vendoset me furçë të butë, me rol ose me anë të sprejtit. Që të arrihet penetrimi i thellë dhe efekti i kënaqshëm, masa duhet të vendoset deri në ngopje sipas principit lagët në të lagur. Nga sipërfaqet horizontale me leckë duhet të hiqet teprica e materialit pas 10 minutave. Efekti i refuzimit të ujit zhvillohet gjatë 24 h nga vendosja.

Temperatura e përdorimit: Temperatura me rastin e vendosjes duhet të arrijë në amplitudë prej +5°C deri +30°C, kurse lagështia relative e ajrit max. 80 %. Nuk duhet të punojmë direkt nëpër diell, në erë, shi dhe mjegull. Lagështia e madhe dhe temperaturat e ulëta mundet dukshëm ta vazhdojnë kohën e tharjes.

Shpenzimi: 0,10 - 0,50 l/m² varësisht nga sipërfaqja që lyhet.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj e magazinuar në temperatura prej +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga ndikimi direkt i dritës së diellit dhe ngrirjes.

Paketimi: 1; 20 l.



Për përdorim të brendshme dhe të jashtme



Përsheptim i shkëlqyeshëm i ujit



Kripëzim të zvogëluar



E zvogëlon zhvillimin e algave dhe mykut

BK-Bet

Bojë akrilike për beton



Përdorimi: Boja akrilike është bërë në bazë të një emulsioni akrilik me cilësi të lartë, të destinuar për mbrojtjen dekorative të sipërfaqeve horizontale dhe vertikale prej betoni, si edhe të sipërfaqeve të tjera prej çimentoje. Karakterizohet nga papërshkueshmëria e shkëlqyer nga uji, ngjitja në shtresa prej çimentoje dhe rezistenca e shkëlqyer ndaj gërryerjes, rrezeve UV dhe kushteve atmosferike. Nuk rekomandohet për rilyerjen e sipërfaqeve të ekspozuara ndaj ngarkesave me frekuencë të lartë (garazhe publike, qendra tregtare, depo etj.).

Ngjyra: E bardhë, kafe, e zezë, e kuqe, gështenjë, lajthi, ulliri, okër, blu, gri, kafe, terrakota, jeshile, e verdhë.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset boja duhet të jetë e fortë, e pastër, e thatë dhe e lyster me bazën BK-Grund Universal ose BK-Bet të holluar me 25% ujë. Përgatitja e bojës realizohet duke shtuar 5% ujë, me përzierje të mirë deri në homogjenizim të plotë. BK-Bet zakonisht vendoset me furçë ose rrul me dy shtresa. Shtresa e dytë vendoset pas tharjes së plotë të shtresës së parë. Është e nevojshme të punohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa ndalesa në sipërfaqet e vazhdueshme. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Temperatura e përdorimit: Nga +5°C deri +30°C. Të mos punohet direkt në diell, shi dhe erë të fortë.

Shpenzimi: Rreth 0.4 kg/m², në varësi të thithshmërisë dhe ashpërsisë së sipërfaqes.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 18 muaj në paketimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 1 kg; 5 kg



Mbrojtje e shkëlqyer e betonit



Odlična UV zaštita UV mbrojtje e shkëlqyer



14 nuanca standarde



BK-PoliCid

Agjent për parandalimin e mykut në muret e brendshme



Përdorimi: Lëndë e lëngshme antifungale si suplement për bojërat dispersive të brëndshme, mbron shtresën e bojës së aplikuar nga veprimi i mikroorganizmave me qëllim ruajtjen e karakteristikave të dëshirueshme të bojës së aplikuar.

Përgatitja dhe vendosja: Para përdorimit shishja të tundet mirë dhe BK-Poli Cid-i të përzihet mirë me bojën dispersive. Të lyhen sipërfaqet. Sipërfaqja e lyer e tharë nuk është e rrezikshme për njeriun. Për tharjen e sipërfaqes në varësi të kushteve duhen 4-6 orë. Sipërfaqet e infektuara fillimisht dizinfektojnë me BK-Sani Cid. Produkti mund të përdoret gjatë aplikimit të ri të bojës. Aplikohet me rrul dhe/ose furçë.

Vërejtje: Gjatë hollimit përfundimtarë, sasia e bojës dispersive duhet pakësuar me sasinë e BK-Poli Cid-it i cili është përzier me atë bojë.

Shpenzimi: Rreth 0,050-0,100 l/kg ngjyra e brendshme.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: Deri në 12 muaj në ambalazhimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, larg dritës së diellit dhe ngrirjes.

Paketimi: 500 ml



Shtojcë për ngjyrat e brendshme dispersive



Për mbrojtje preventive

BK-Sanacid

Mjet për mënjanimin e mykut dhe algave të mureve



Përdorimi: Koncentruar agjent të lëngshme biocide për mbrojtjen dhe trajtimin e mëtejshëm të sipërfaqeve ndërtimurore të gurë, tulla, beton, me përjashtim të drurit, nga veprimi i dëmshëm i mikroorganizmave.

Përgatitja dhe vendosja: Përgatitet lëngu i holluar. Për të përgatitur lëngun e holluar fillimisht tundet mirë shishja me lëndën biocide dhe pastaj BK-Sani Cid hollon me ujë në relacin 1:5 (një pjesë BK-Sani Cid dhe 5 pjesë ujë). Sipërfaqet lyhen me hollim derisa ai të shkurzohet. Për tharjen e sipërfaqes në varësi të kushteve duhen 2-4 orë. Pas 24 orësh sipërfaqja e fasadës së lyer duhet shpërlarë me ujë, ndërsa sipërfaqet e brëndshme mund të lahen me një leckë të lagur. Sipas nevojës lënda mund të vendoset disa herë duke përsëritur procedurën me distancë 24 orësh. Vendoset me furçë, rrul ose sfungjer derisa të laget plotësisht sipërfaqja dhe lënda të shkurzohet.

Vërejtje: Produkti nuk është i përshtatshëm për tu përzier me lëndë të tjera për lyerje.

Shpenzimi: 0,050-0,100 l/m²

Kohëzgjatja dhe ruajtja: Deri në 12 muaj në ambalazhimin origjinal. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, larg dritës së diellit dhe ngrirjes.

Paketimi: 500 ml.



Për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm



E koncentruar (1:5)



Nuk i zbardhë sipërfaqet e ngjyrosura

BK-SaniCid Express Sredstvo za uklanjanje buđi, gljivica i bakterija



Përdorimi: Produkti i lëngshëm biocid për heqje efektive të mykut, kërpudhave dhe bakterieve, që zbardhon sipërfaqet në të cilat vendoset. Mund të përdoret në sipërfaqe të ndryshme, siç janë: muret, pllakat, qeramika, fugat, suva, tulla, gurë, smalt, plastikë, akril, silikon, goma, çelik që nuk ndryshket. Nuk përdoret për gjips, metalet-alumin, bakër, tunxh, bronz, të ngjyrosur dhe dru të lyer me lak. Në rast të përdorimit të llojeve të reja jo të zakonshme të sipërfaqeve, fillimisht të provohet ndikimi në një sipërfaqe që nuk duhet. BK-SaniCid Express mund të përdoret përveç në amvisëri, edhe në objektet e shëndetit publik si dhe nëpër objektet publike dhe industriale për trajtimin e sipërfaqeve që nuk vijnë në kontakt me ushqimin e njerëzve dhe kafshëve.

Përgatitja dhe vendosja: Rrotullojeni pipëzën e spërkatëses në pozitën e punës dhe pas përdorimit gjithmonë të mbyllet spërkatësja me rrotullimin e pipëzës të spërkatëses në pozitën stop. Të spërkatën me sprej vendet problematike me rreth 15 cm largësi dhe lëreni që të veprojë më së paku 15 minuta. Pas kohës së përmendur, lajeni sipërfaqen e trajtuar me ujë. Mos e largoni mykun para se të vendoset preparati dhe nëse është e nevojshme të përsëritet procedura qysh pas larjes së sipërfaqes dhe tharjes së të njëjtës. Duhet të largoheni nga vendosja e tepruar e sprejit, sepse sipërfaqet e trajtuara nuk duhet të jenë të lagura shumë, por të spërkatura mesatarisht.

Harxhimi: Rreth 0,050 l/m² në një shtresë, kurse pë të trajtimin e sipërfaqeve më të vogla (10cm²) 5 shtypje.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: Deri 12 muaj në ambalazhin original të paketuar. Të ruhet në temperaturë prej +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 500 ml



Për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm



Përdorim i shpejtë dhe i thjeshtë



I largon algat dhe mykun e mureve





BK-BlockFix

Llaç për ndërtim me blloqe prej gazbetoni

Përdorimi: Llaç shtresëhollë me bazë çimentoje i destinuar për ndërtim me blloqe prej gazbetoni.

Përgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën aplikohet llaçi duhet të jetë e fortë, e pastër dhe e rrafshët. Përgatitet duke shtuar pluhurin në afërsisht 24-26% ujë dhe duke përzier fort deri në homogjenizimin e plotë. Masa lihet që të qëndrojë për afërsisht 10 minuta dhe pastaj përzihet përsëri për të siguruar një llaç me dendësi të përshtatshme dhe pa kokrra. Ngjitësi aplikohet duke përdorur një mistri të dhëmbëzuar në sipërfaqen e sipërme të blloqeve, si edhe në sipërfaqet anësore, me qëllim për t'i lidhur blloqet. Trashësia maksimale e ngjitësit është 10 mm.

Të dhënat teknike: Kushtet atmosferike optimale: temperatura e nënshtresës dhe ajrit midis +5°C dhe +25°C.

Konsumi indikativ: 12-13 kg/m²/cm, në varësi të trashësisë së aplikimit.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal, në një hapësirë të thatë, mbi paleta.

Paketimi: 25 kg



Përdorim i shpejtë
dhe i thjeshtë



Punueshmëri e
shkëlqyeshme





Banja Komerc Bekament DOO

Arandjelovac, 34304 Banja, Serbia

Tel: +381 34 6777 500; Faks: +381 34 6777 506

www.bekament.com